

VENDIM

Nr. 163, datë 27.2.2013

PËR NJË NDRYSHIM DHE SHITESË NË VENDIMIN NR. 396, DATË 31.3.2005 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR MIRATIMIN E KUFIJVE DHE RREGULLORES SË ADMINISTRIMIT TË PARQEVE ARKEOLOGJIKE TË SHKODRËS, LEZHËS, APOLONISË, BYLISIT, AMANTIAS, ORIKUMIT, ANTIGONESË, FINIQIT DHE BUTRINTIT"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 2 të nenit 7 të ligjit nr. 90/2012 "Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore", dhe të neneve 29 pika 2, e 53 pika 2 të ligjit nr. 9048, datë 7.4.2003 "Për trashëgiminë kulturore", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në rregulloren e administrimit të parqeve arkeologjike, miratuar me vendimin nr. 396, datë 31.3.2005, të Këshillit të Ministrave, bëhen ndryshimi dhe shtesa e mëposhtme:

a) Në shkronjën "b" të pikës 3 dhe në pikën 11 të rregullores, hiqen fjalët "... Amantias, Orikumit ...".

b) Pas shkronjës "c" të pikës 3 të rregullores shtohet shkronja "d", me këtë përmbajtje:

"d) Struktura përgjegjëse për administrimin e Parkut Arkeologjik Amantia-Orikum, sipas kësaj rregulloreje, është Drejtoria Rajonale e Kulturës Kombëtare Vlorë."

2. Ngarkohen Zyra e Administrimit dhe Koordinimit të Parkut Arkeologjik Amantia-Orikum të dorëzojë të gjithë dokumentacionin ligjor pranë Drejtorisë Rajonale të Kulturës Kombëtare Vlorë, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga data e hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Sali Berisha